



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**Kom.Dh.shk.II.nr.1218/2023**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e Shkallës së Dytë, në përbërje nga gjyqtari individual Faton Bajrami, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Beni Dona Plast” shpk, me numër identifikues 70238636 me seli ne Prishtinë, kundër debitorit Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me seli ne Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.170/22, të datës 30.06.2023, me datë 01.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e kreditorit “Beni Dona Plast” shpk, me numër identifikues 70238636 me seli ne Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.170/22, të datës 30.06.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.170/22, të datës 30.06.2023, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me seli ne Prishtinë, i ushtruar kundër Urdhrit të Përmbartuesit Privat Isa Gacaferri P.nr.2131/19 të dt.03.07.2019, andaj ka shfuqizuar urdhrin e përmbartimor.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, ta aprovojë si të bazuar ankesën e kreditorit, ashtu që të ndryshojë aktvendimin e atakuar dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbartimorë P.nr.2131/19 të dt.03.07.2019, ndërkaq prapësimin e debitorit ta refuzoi në tërësi, apo t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur pala debitore.

Gjykata Komerciale, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 dhe nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

*Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Beni Dona Plast” shpk, me numër identifikues 70238636 me seli ne Prishtinë, me datë 02.07.2019, ka paraqitur propozim për përbarim, kundër debitorit Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me seli ne Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës me nr.132/2017 se dt.29.12.2017, për prestimin e pakryer, ne shumën prej 1330.00 euro, si dhe te gjitha shpenzimet e procedurës perbarimore.

Përbaruesi priva Isa Gacaferri t, duke vepruar në bazë të propozimit për përbarim të kreditorit me urdhrin P.nr.2131/19 të dt.03.07.2019, ka lejuar përbarimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori me datë 10.07.2019, ka ushtruar prapësim duke theksuar se fatura nuk është pranuar nga debitor, është e panënshkruar nga personi kompetent, nuk është e vulosur me tej debitori ne kundërshtimet e tij ka theksuar se fatura ne rastin konkret nuk përbenë dokument përbarues, andaj i propozon gjykatës qe te aprovoj kundërshtimet si në prapësim.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori, me dt. 11.07.2019, duke theksuar se janë të pa bazuara pretendimet e debitorit në prapësim dhe se e kundërshton kërkesën e debitorit që të mos realizohet përbarimi duke theksuar se debitori nuk e ka dhënë asnjë arsye si ne kuptim te nenit 71 te LPP qe te aprovohet prapësimi, andaj edhe ka kërkuar që të refuzoi prapësimin, dhe urdhri përbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.170/22, të datës 30.06.2023 me të cilin e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe e ka shfuqizuar urdhrin për lejimin e përbarimit P.nr.2131/19 të dt.03.07.2019, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivit të të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se me shikim në shkresat e lëndës ka gjetur se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përbarim të dokumentit të besueshëm - faturës me nr.132/2017 se dt.29.12.2017, për prestimet e kryera, ne shumën prej 1330.00 euro, mbi bazë të së cilës përbaruesi privat e ka lejuar përbarimin, por ky dokument nuk përben bazë juridike për caktimin e përbarimit, ngase nuk i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 29 dhe 37 të LPP-së, për faktin se ky dokument nuk e ka cilësinë e dokumentit përbarimor, e po ashtu nga shiqimi ne ketë dokument rezulton se nuk përmban vulën e pranimit te debitorit në faturë, e as nuk ka ndonjë prove me te cilën vërtetohet fakti se ketë e ka pranuar debitori Andaj edhe mbi bazën e këtyre fakteve gjykata e shkallës së parë ka aprovuar prapësimin e debitorit dhe ka shfuqizuar urdhrin përbarimor.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkalles se Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përbarim, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës ku me dispozitën e nenit 29 të Ligjit

për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139, përcaktohet se përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së është fatura. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret kemi të bëjmë me dokumentin-fatura e cila nuk paraqet dokument të besueshëm, pasi që e njëjta nuk është pranuar dhe protokolluar me vule nga ana e debitorit dhe si e tillë nuk paraqet bazë juridike për caktimin e përmbarimit në kuptim të dispozitës së nenit 21 të LPP-Se. E po ashtu edhe gjykata e shkallës së dytë, pajtohet në tërësi me qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë ky dokument nuk përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase nuk i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 29 dhe 37 të LPP-së, për faktin se ky dokument nuk e ka cilësinë e dokumentit përmbarimor.

Kjo gjykatë vlerëson se palët ndërgjyqëse mund të iniciojnë procedurë në gjykatën kompetente, për ti provuar pretendimet e tyre rreth mos përmbushjes së detyrimeve që dalin nga raporti detyrimor dhe se fatura në fjalë, në këtë fazë, duke pasur parasysh çështjet kontestuese të lartcekura, si të tilla, janë të pa përshtatshme për përmbarim, siç me të drejtë konstatoj edhe gjykata e shkallës së parë. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Gjykata e shkallës së dytë i shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore të kreditorit, por të njëjtat nuk ndikuan në një vendim ndryshe.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhoma e Shkallës së Dytë**  
**Kom.Dh.shk.II.nr.1218/2023, me datë 01.03.2024**

**Gjyqtari,**  
**Faton Bajrami, d.v.**